June 26, 1964 Report on the 1st and 2nd Conference of Non-Aligned Countries

Citation:

"Report on the 1st and 2nd Conference of Non-Aligned Countries", June 26, 1964, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh V. 1961 D 422, p. 46-51 https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110537

Summary:

According to this report, the African and Asian countries were not satisfied with the 1st Belgrade conference and were trying to call what is known today as the 2nd non-aligned conference in Bandung. Tito and Nehru also reiterated the need for the 2nd conference of non-aligned countries in order to undermine the attempts of the former in initiating the effort. According to the Western press, Nehru took the initiative and sent his Vice-Foreign Minister, Dinish Sing, to Cairo and Belgrade where he met Nasser and Tito, both of whom were expecting him. Tito called for more participants from Africa, Asia, and Latin America. According to Tito's recommendation, on March 23, 1964, in Colombo, Ceylon, the preparatory meeting was held on the ambassadorial level of Asian, African, and Latin American countries about the upcoming conference. The Soviet Union expressed its support for this conference in Soviet media. The report reveals the following to be discussed topics at the conference: peace, peaceful coexistence, resolution of disputes without the use of force, disarmament, etc. The Albanian government supports the conference of non-aligned countries in principle, but it does not show enthusiasm and avoids promoting the conference in Albania, in the media, and in the international arena. In addition, the report stresses that Albanian diplomats are ordered to follow the Ministry's guidelines in order to maintain specific policies targeted at each Asian and African country individually.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

to lead

· Vit. osjak

KONFERENCA E VENDEVE TE PA ANGAZHUARA

I DEKLASIFIKUAR

I) Konferenca e pare e vendeve te pa angazhuara (Beograd 1 shtator 1961)

Konferenca u mblodh ne nje kohe kur Indonezia dhe disa vende te tjera te Azise dhe Afrikes benin perpjekje per te thirur mbledhjen e konferences se dyte te Bandungut. Nehruj duke vene si pretekst konfliktin kino-indian, me qellim qe te mos ulej me nje tavoline me Kinen dhe qe konferenca te mos merrte nje karakter te theksuar anti-imperialist e anti-kolonial u shpreh kundra thirrjes se konferences se dyte te Bandungut. Me gjithate presioni i vendeve aziatiko-afrikane per nje mbledhje te kryetareve te shteteve te ketyre vendeve ishte i math, si rjedhim Nehruj dhe Titua per ti dale perpara situates, muarne inisiativen per organizimin e nje konference tjeter, te cilen e quajten "konferenca e vendeve te pa angazhuara".

Ne konferencen e Beogradit muarne pjese keto 24 vende:

Afganistani, Algjeria, Birmania, Kambbxhia, Ceiloni, Kuba, Qpprua, Ethiopia, Gana, Guinea, India, Indonezia, Iraku, Libani, Mali, Maroku, Nepali, Arabia Saudite, Somalia, Sudani, Tunizia, RAB-i, Jemeni dhe Jugosllavia; ndersa Bolivia dhe Ekuadori kishin derguar vezhgues. Perveç ketyre ne konference derguan vezhgues edhe 20 parti dhe organizata politike nga vende te ndryshme.

Konferenca, ne seancen e saje te pare, aprovoi kete rend dite :

1) Shkembim i pikpamjeve mbi gjendjen nderkombetare,

2) Ruajtja dhe forcimi i pages dhe i sigurimit ne bote:

a- respektimi i te drejtave te popujve dhe te kombeve per vetvendosje, lufta kundra imperializmit, likuidimi i kolonializmit dhe i neokolonializmit,

b- respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial te shteteve, mos nderhyrja ne punet e brendeshme te vendeve te tjera,

c- diskriminimi racial dhe apartaidi,

ç- Carmatimi i plote dhe i pergjithesnem, ndalimi i provave te armeve berthamore, çeshtja e bazave te huaja ushtarake,

d- bashkeekzistenca pagesore midis shteteve me

./..

Origina

ND FR

Vit: osiak Original Scan

sisteme te ndryshme politike dhe shoqerore,

e- Roli dhe struktura e OKB dhe zbatimi i rezolutave te saje,

3) Problemi i ndihmes ekonomike dhe i bashkepunimit ekonomik dhe teknik ne fushen nderkombetare,

4) Te ndryshme,

I DEKLASIFIKUAR

5) Komunikata e konferences

Imperialistet dhe revizionistet u munduan qe konferencen ta ofrytezojne per qellimet e týre, qe ne te te penetroje vija e tyre, kjo ne radhe te pare nepermjet Titos dhe Nehrugt, keta vepruan me kujdes per te mos u komprometuar vija e tyre e "mos angazhimit".

Ne fjalimet kryesore qe u mbajten, ne menyre te permbledhur del sa vijon :

Konferenca u hap nga Titua, ne fjalimin e tij, duke folur mbi gjendjen nderkombetare ai tha se "Lufta e ftohte ka marre proporcione te atilla, te cilat mund te çojne ne nje tragjedi te tmerreshme nga çasti ne çast", dhe se lidhur me kete perfaqesuesit e vendeve te pa angazhuara duhet te ndermarin veprime te koordinuara, ne radhe te pare nepermjet OKB-se, me qellim qe te ndalohet shperthimi i nje konflikti te ri ushtarak. Ai dekllaroi se konferenca duhej te merrte nje qendrim negativ kundrejt pjesemarrjes ne blloqe dhe shtoi se konferenca nuk kish per qellim qe te krijonte nje bllok te trete.

Mbas aprovimit te rendit te dites, Titua e mori fjalen per se dyti dhe foli per çarmatimin, krizen e Berlinit, kokonializmin, problemet ekonomike dhe bashkeekzistencen paqesore. Theksin e vuri mbi "rrezikun e madh te luftes" por nuk shpjegoi se shkaktaret jane imperialistet dhe ne vend qe te denonte keta, denoi me force te madhe vendimin e qeverise sovjetike per rifillimin e provave te armebe bebthamore. Foli shume per bashkeekzistencen paqesore pozitive, ndersa per problemin kryesor te kohes, te luftes kundra imperializmit ne te dy fjalimet nuk tha asnje fjale. Edhe per çeshtjen koloniale dhe luften e popujve te shtypur kundra kolonializmit foli fare perciptas. Titua i beri thirrje konferences qe te mos behen sulme kunder ketij apo atij vendi. Kjo qe mbrojtje e hapur per imperializmin amerikan.

Ne Konference duallne kontradikta midis delegacioneve te ndryshme ne lidhje me percaktimin se cilat ishin problemet kryesore qe duhej te merej konferenca.

osjāk

1. Kight

Si Nehruj ashtu dhe Titua, ne fjalimet e tyre duallne me tezen se problemi kryesor i kohes ishte çeshtja e "luftes dhe paqes" dhe per kete ata sugjerojne qe nga ana e pjesmarresve te behej nje diskutim i pergjitheshem.

I DEKLASIFIKUAR

Original Scan

Delegacionet e vendeve te tjera, sidomos ai i Indonezise, Kubes, Ganes, Guinese, Malit, Algjerise, etj. mbronin pikpamjen se problemi kryesor eshte çeshtja e luftes kunder imperializmit dhe kolonializmit te ri dhe te vjeter, siç e cilesuan ata, "imperializmi dhe kolonializmi eshte burimi i tensionit nderkombetar". Ne nje interviste Sukarnua deklaroj se ne radhe te pare eshte lirija pastaj "paqia dhe lufta".

Perpjekjet e Nehrujt e te Titos nuk u realizuan sipas deshires se tyre, ne konference deri ne nje fare mase u denua imperializmi dhe kolonializmi.

Konferenca adoptoi dy dokumenta: nje manifest te titulluar "Rreziku nga lufta dhe thirrja per paqe" si dhe dekllaraten.

Manifesti ka mjaft te meta dhe eshte krejtesisht ne fryme revizioniste. Ay tremb popujt me rrezikun e shperthimit te nje lufte berthamore dhe e le fatin e botes ne meshiren e fuqive te medha, duke iu drejtuar nje thirrje Kenedit dhe Hrushovit qe te mirren vesh per çdo gje per te shpetuar boten nga lufta, etj. Ne fund i behet thirrje gjithe kombeve qe ti luten Kenedit dhe Hrushovit per te ruajtur pagen.

Ne dekllarate ka gjera pozitive, sepse flutet deri diku kundra imperializmit dhe kolonializmit, me gjithese jo aqe shume dhe me aqe force sa u fol ne dekllaratat e kryetareve te shteteve gjate punimeve te konferences.

Konferenca e Beogradit nuk pati asgje konkrete dhe mund te themi se nuk dha asnje rezultat. Me nje here mbas mbarimit, ne fakt, mbarci dhe jehona e saj. Ne fjalimet e mevoneshme politike te mbajtura nga personalitete te vendeve te Azise dhe Afrikes shume ralle eshte permendur konference e Beogradit, ne te kunderte, duke goditur imperializmin dhe kolonializmin, ata shpesh i referchen vendimeve te kohferences se Bandungut.

Viti

11

osjāk

Original Scan

46

Ne vendin tone, nje jave mbasi mbaroi konferenca, u botua nje artikull ne "Zerin e Popullit" ku vihet ne dukje fryma luftarake e delegacioneve te ndryshme te vendeve Aziatiko-afrikane kundra kolonializmit, imperializmit dhe demaskohet Titua si agjent i imperializmit dhe vihet ne dukje se Jugosllavia nuk eshte vend i pa angazhuar mbasi ben pjese ne Paktin Ballkanik.

I DEKLASIFIKUAR

II) <u>Pregatitjet per konferencen e dyte te vendeve te</u> pa angazhuara

Duke marre parasysh se konferenca e Beogradit nuk justifikoi deshirat e popujve qe luftojne kunder imperializmit e kolonializmit, menjehere mbas saj,vendet aziatiko-afrikane vazhduan perpjekjet per te thirrur konferencen e dyte te Bandungut. Per kete qellim u bene edhe takime per te shkembyer mendime midis Kines, Indonezise,Malit, Guinese, Birmanise, etj. Per te penguar kete, duallne perseri Nehrui, Titua dhe Naseri me propozimin e nje konference te dyte te Beogradit. Ishte e kjarte se kjo u be me qellim per t'ia kundervene konferences se dyte te Bandungut, te pengonin mbledhjen e saj dhe te vazhdonin lodren e imperialisteve dhe te revizionisteve. Mbas mbledhjes se komitetit pregatitor te kohferences se Bandungut, filloi aktiviteti me i gjere per konferencen e dyte te yendeve te paangazhuara dhe ne janar 1964 u shkembyen mesazhe dhe u bene konsultime midis Titos-Naserit dhe Nehruse, per organizimin e saj.

Ne baze te njoftimeve te shtypit perendimor,del se nisiativen kete radhe e mori Nehrui, i cili dergoi per konsultime Zv.Ministrin e Jashtem Dinish Sing, ne Kairo e Beograd, ku u prit nga Naseri dhe Titua. Ndersa Naseri dha pelqimin per organizimin e mbledhjes se dyte te vendeve te pa angazhuara me ato vende qe muarne pjese ne konferencen e Beogradit, Titua ne takimin e tij me Singup, propozoi qe pjesemarrja ne konferencen e dyte te zgjerohet me vende te reja. Nehrui propozoi qe mbledhja pregatitore ne nivelin e ambasadoreve te behet ne Kajro, ndersa Titua sugjeroi qe kjo te mbahet ne Kolombo (Ceilon) dhe mbledhja e dyte e kryetareve te ketyre vendeve te behet ne Kajro,ne mbarim te veres (1964). Nga perpjekjet e Titos duket se ai kerkon qe ne kete konference te marin pjese sa me shume vende te Azise, Afrikes, Amerikes Latine sidomos vendet qe sapo kane fituar pavaresine kombetare dhe kjo me qellim qe edhe keto ti neneshtrohen politikes se imperialisteve

osjak

I DEKLASIFIKUAR

Original Scan ____ MPJ ARKIVI Viti; DosjaN⊨ Fleta

dhe revizionisteve nen masken e te "pa angazhuarve". Kjo del me kjarte po te shihet mbeshtetja qe i bene ketyre pregatitjeve shtypi dhe propaganda zyrtare e Bashkimit Sovjetik dhe ajo perendimore, por kjo e fundit ne nje menyre me te kamufluar.

Qeverite e RAB-it, Ceilonit dhe Jugosllavise, me 17 shkurt 1964, i derguan ftesa te gjitha vendeve qe muarne pjese ne konferencen e Beogradit per te derguar perfaqesuesit e tyre ne takimin pregatitor ne nivelin e ambasadoreve, ne gjysmen e dyte te marsit ne Kolombo. Sovjetiket nuk munguan te japin perkrahjen e tyre me nje here, kesaj mbledhje paraprake. Ne nje artikull te saj "Novoe Vremja" (Nr.9) qe transmetohet nga agjensia TASS date 26 shkurt 1964 nder te tjera shkruan : "Cilido qe shprehet jo me fjale, por me vepra per uljen e tensionit nderkombetar, qe synon me te vertete ne regullimin paqesor te problemeve qe u ka ardhur koha te zgjidhen, mbeshtet idene e thirrjes se konferences se shteteve te pa angazhuara e cila do te sjelle, pa dyshim, nje kontribut te ri pozitiv ne arenen nderkombetare".

Mbledhja pregatitore ne rangun e ambasadoreve u mbajt ne Kolombo, me 23 mars 1964. Ajo i filloi punimet nene kryesine provizore te G.S. Peiris, drejtor i pergjitheshem i Ministrise se Jashteme te Cejlonit. Kryetar i saj u zgjodh Sain P.S. Fernando, Ambasador i Cejlonit ne RAB dhe ish minister i drejtesise i qeverise se Cejlonit, u zgjodhen dhe 4 zevendes kryetare, nje raportonjes dhe nje sekretar i pergjitheshem. Mbledhja u pershendet nga Kryeministria e Ceilonit Bandaranajka. Mbas aprovimit te rendit te dites u kalua ne diskutimin e problemeve konkrete.

Lidhur me perberjen e Konferences u vendos qe numuri i antareve te konferences se Beogradit te rritet nga shtetet e kategoriwe qe vijone:

a) Shtetet ancare te organizates se unitetit afrikan,

b) Shtetet qe muaren pjese ne konferencen e vendeve arabe te nivelit te larte (janar 1964).

Per Niasalandin dhe Rodezine Veriore u vendos unanimisht qe te pranohen si anetare te konferences me te drejta te plota, neqoftese fitojne pavaresine e tyre deri ne kohen e fillimit te punimeve te kohferences. Mbas disa diskutimesh, u pranua manimisht, qe te ftohet qeveria provizore e Angoles e kryesuar nga Roberto Loder

Vilson Center, Digital Archive Vii I DEKLASIFIKUAR

OS jë h

MPJ ARKIVI Viti; Dosja₩ Fleta: Origina

si antare me te drejta te plota. Po keshtu u pranua unanimisht qe shtetet e poshte shenuara te futen ne listen e te ftuarve te Konferences: Laosi, Xhamajka, Trinidad - Tobago, Brazili, Bolivia, Meksika, Kili, Uruguaj, Argjentina, Finlanda, Austria dhe Suedia.

Ŧ

U vendos gjithashtu qe te ftohej edhe Venezuela. Lidhur me kete delegati i Kubes beri nje deklarate ne te cilen theksohej se geveria e tij ishte kundra ftimit te Venezueles. Kerkesa e Kubes nuk u pranua dhe u vendos qe Venezuela te ftohet, per mbrojtjen e kesaj nje rol shume te poshter luajti delegacioni jugosllav.

Per perfaqesimin e levizjeve nacionale te territoreve te varura, u krijua nje nen-komitet i perbere prej delegateve te Algjerise, Ganes, Indise dhe Marokut. Mbas shqyrtimit te çeshtjes nga ky nen-komitet, delegati indian i paraqiti raportin mbledhjes. Rekomandimet e tij perbeheshin prej dy pjeseve: a) per levizjet nacionale te territoreve te varura dhe b) per qeverite provizore, te cilat mund te formohen deri ne thirrjen e Konferences. Me ne fund mbledhja vendosi :

a) Te gjitha levizjet nacionale te kolonive qe nuk e kane fituare akoma pavaresine, mund te çfaqin pikpamjet e tyre ne konference;

b) Ne qoftese do te formohet ndonje qeveri provizore ne Afrike deri ne thirrjen e konferences, Komuteti do ta ftoje ate si antare me te drejta te plota, po qe se ajo njihet nga organizata e Unitetit afrikan:

c) Ne goftese do te formohet ndonje geveri provizore jo ne kontinentin afrikan deri ne thirrjen e konferences, Komiteti, mbasi ta studjoje çeshtjen dhe te marre aprovimin e te gjitha shteteve antare, do t'a ftoje ate ne punimet e konferences.

Mbledhja diskutoi edhe çeshtjen e Guajanes britanike dhe vendosi qe ajo te ftohet si antare me te drejta te plota, neqoftese shpall pavaresine e saj deri ne thirrjen e konferences.

Unanimisht u vendos qe konferenca te mbahet ne Kajro, rreth javes se pare te muajit tetor. Rendi i dites se konferences do te jete ky :

1) Diskutime te pergjitheshme mbi gjendjen nderkombetare;

2) Mbrojtja dhe forcimi i pages boterore, sigurimi dhe nxitja e tendencave pozitive dhe e forcave te reja accionaliste ne ceshtjet nderkombetare;

•/••

a) Bashkeekzistenca paqesore dhe kodifikimi i principeve te saj nga Kombet e Bashkuara, respektimi i sovranitetit teritorial, problemet e kombeve te ndare;

MPJ ARKIVI

Fleta

Viti:

DosjaN.

Original, Scan

b) Kolonializmi, neokolonializmi dhe imperializmi;

c) Diskriminimi racial dhe politika e apartaidit;

d) Zgjidhja e mosmarreveshjeve pa kercenim dhe pa perdorimin e forces ne perputhje me principet e Kartes se Kombeve te Bashkuara dhe veçanerisht e drejta e kombeve per vet-vendosje;

e) Carmatimi i pergjitheshem dhe i plote; ndalimi i te gjutha provave te armeve berthamore, krimini i zonave pa arme berthamore, ndalimi i shperndarjes se armeve berthamore dhe shkaterimi i tyre;

f) Paktet ushtarake, trupat dhe bazat e huaja;

g) Kombet e Bashkuara, roli i tyré ne çeshtjet nderkombetare, aplikimi i rezolutave te tij dhe amendimi i Kartes se OKB-se.

3) Zhvillimi ekonomik, bashkepunimi dhe efektet e çarmatimit ne zhvillimin e ekonomise boterore. Konferenca e OKB-se mbi tregetine dhe zhvillimin.

4) Ç'do lloj teme tjeter

I DEKLASIFIKUAR

/ilson Center Digital Archive

osjāk

F

Per zbatimin e vendimeve te mbledhjes pregatitore u ngrit nje Komitet drejtonjes i perbere prej perfaqesuesve te Algjerise, Cejlonit, Etiopise, Ganes, Guinese, Indise, Indonezise, Irakut, RAB-it dhe Jugosllavise. Pastaj u pranua unanimisht rekomandimi i nen-komitetit per thirrjen e nje mbledhjeve te Ministrave te jashtem para konferences se kryetareve te shteteve. Kjo mbledhje do t'i zhvilloje punimet e saj po ne Kajro. Data e mbledhjes do te njoftohet me vone nga Komiteti drejtonjes. Ne fund mbledhja dolli me nje komunikate te perbashket.

Lidhur me mbledhjen e Kolombos, i ngarkuari me pune a.i. i Kubes ne Tirane na njoftoj se delegacioni jugosllav ka luajtur rolin kryesor si persa i perket caktimit te çeshtjeve per diskutim ashtu dhe per shtetet qe do te ftohen te marin pjese.ne konference. Jugosllavet vepronin direkt por me shume nepermjet delegateve te vendeve arabe sidomos delegacionit te Arabise Saudite. Delegacioni kuban kish marre takim me delegacionin jugosllav dhe kish kerkuar qe Venezuela te mos ftohej ne konferencen e dyte te vendeve te pa angazhuara per aresye te rregjimit te saj thellesisht reaksionar. Delegacioni jugosllav me 3-4 takime nuk kish mbajtur asnje qendrim dhe ne fund, pa asnje lajmerim, ne mbledhje kish perkrahur nxehte-

Original Scan

ilson Center Digital Archive

111

DSjet

MPJ ARKIV. Viti; Dosja#

sisht pranimin e Venezueles per ne konference. Delegacioni kuban beri nje proteste te forte delegacionit jugosllav duke vene ne dukje se ne çeshtjen e Venezueles ata po perkrahin imperializmin amerikan. Me një here mbas kesaj u botuan artikujt anti jugosllav ne shtypin kuban dhe pergjigjet e shtypit jugosllav kundra Kubes.

Edhe ne shtypin tone u botua nje artikull ne "Zerin e Popullit" ne perkrahje te Kubes ku dhe u demaskuan pllanet e imperializ mit dhe te agjentures se saje klikes Titos.

III- Konkluzione:

I DEKLASIFIKUAR

- 8 -

1) Nga rendi i dites i aprovuar ne mbledhjen e Kolombos per konferencen e dyte te vendeve te pa angazhuara, duket kjarte se synimi i Titos, Nehrujt (indianeve me qe Nehruj vdiq) dhe Naserit eshte qe ajo te orientohet ne rrugen e revisionisteve, qe ne fakt iu sherben imperialisteve. Keshtu ne rendin e dites theksi kryesor vihet mbi : çeshtjen e paqes, bashkeekzistencen paqesore, zgjidhjen e mosmarreveshjeve pa" perdorimin e forces, çarmatimi i pergjitheshem e;1; plote, efektet e çarmatimit ne zhvillimin e ekonomise boterore, teza keto te servirura nga revizionistet dhe te perkrahura edhe nga imperialistet. Ne rendin e dites figurojne dhe: kolonializmi, neokolonializmi, imperializmi dhe politika e diskriminimit racial, keto duket sa per forme e per tu maskuar perpara popujve. Ne te vertete vendin kryesor ne rendin e dites e zene problemet e grupit te pare, d.m.th. fryma e pajtimit, bashkeekzistenca me imperialistet dhe kolonialistet.

Qendrimet e paleve te ndryshme mbi problemet e lartpermendura ne pergjithesi dihen, ato jane shprehur ne organizaten e Kombeve te Bashkuara, ose ne raste tjera. Duket se ne konference nuk do te kete unanimitet si per çeshtjen e shteteve pjesemarrese ne te ashtu dhe per problemet ge fo te trajtohen.

2) Qellimi i vertete i frymezuesve dhe organizatoreve te konferences, imperialisteve dhe revizionisteve eshte qe ta perdorin si mjet per te neutralizuar karakterin antiimperialist e antikolonialist te politikes se vendeve afro-aziatike dhe per te kanalizuar keto ne nje vije pajtimi me imperializmin dhe revizionizmin,kunder RP te Kines dhe forcave dhe levizjeve revolucionare. Rol kryesor direkt ne kete drejtim lozin Jugosllavia, India, Egjypti.

V i"t -

.

osjāk

I DEKLASIFIKUAR

MPJARKIVI Original Scan_ Viti; Dosjalk Flet

2) Ne radhet e shteteve pjesemarres, perveç nuancave te ndryshme, sundojne dy korente: nje korent antiimperialist e antikolonialist konsekuent dhe nje tjeter i cili nen masken e bashkeekzistences dhe uljes se tensionit, predikon pajtimin me imperializmin dhe eshte ne sherbim te tij. Ne perkrahim korentin e pare dhe kundershtojme te dytin.

3) Ne e perkrahim ne parim Konferencen e vendeve te paangazhuara per shkak te pjesemarrjes ne te te shteteve te korentit te pare, por nuk tregohemi enthusiaste dhe nuk e propagandojme. Ne perkrahjen tone te theksojme karakterin e saj antuimperialist e antikolonialist qe duhet te marre dhe te godasim orvatjet per te dobesuar kete karakter te konferences.

4)Me rastin e çeljes se konferences te pregatiten nje artikull dhe ne kete fryme, te pregatiten tezat.

Gjate punimeve shtypi te jape lajme me tendence mbi zhvillimin e saj.

Te botchet nje artikull tjeter pas konferences per te komentuar zhvillimin dhe perfundimet e saj.

5) Te udhezojme perfaqesite mbi qendrimin tone, sidomos mbi taktiken qe duhet te ndjekin ne takimet me perfaqesuesit afroaziatike.

Ne bisedimet e njerezve tane me afro-aziatiket te perkrahim ne pergjithesi konferencen duke e lidhur me politiken antiimperialiste te vendeve afro-aziatike dhe te demaskojme kliken e Titos dhe rolin e saj perçares ne sherbim te imperializmit, me shembulla konkrete, lidhur me vendin tone ne radhe te pare.

Gjate kesaj periudhe, ne vendet afro-aziatike dhe ne Kube si dhe prane diplomateve dhe studenteve te ketyre vendeve te zgjerojme shperndarjen e materialeve tona qe demaskojne kliken e Titos.-

Tirane, me 26 gershor 1964